



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 19.02.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

- Sa përmbytje ka pasur në territorin e bashkisë në 10 vitet e fundit?

Spektori I Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, disponon informacion për vitet si më poshtë:

2018

Banesa të përmbytura: 114

Vlera e fondit te akorduar: 32,950,500, Likujduar

2020

Banesa të përmbytura: 388

Vlera e fondit te akorduar: 47,013,200, Likujduar

2025 (janar - shkurt)

Banesa të përmbytura: 431

Vlera e fondit të akorduar: 121,429,639.38, likujduar pjesërisht 12,282,627 lekë

2025

(Përmbytjet muaji shtator,
muaji nëntor, në proces vlerësimi të dëmeve).

2026

(muaji janar, në proces vlerësimi)

Numer totali 2579 banesa total.

Në lidhje me kërkesën për bizneset, për të gjitha periudhat e kërkuara nuk ka evidenca pasi dëmet e shkaktuara në biznese nuk janë trajtuar pasi në kuadër të VKM nr. 329/2012 në kushtet e mosshpalljes së gjendjes së emergjencës civile nuk janë marrë në konsideratë.

- A janë marrë masa parandaluese nga ana bashkisë apo vetëm reaguese ndaj përmbytjeve?

Në fillim të cdo viti kalendarik, Bashkia Durrës, ndëpërmjet strukturave përkatëse, u dërgon një shkresë zyrtare të gjitha Njësive Administrative, me qëllim evidentimin dhe raportimin e kanaleve kulluese problematike që kërkojnë ndërhyrje për mirëmbajtje. Bazuar në informacionin e përcjellë nga Njësitë Administrative, përgatitet plani vjetor i ndërhyrjeve për sistemin e kanaleve kulluese, si rehabilitim dhe pastrim kanalesh kulluese dhe ndërhyrje grykash urash të cilat kanë qenë të bllokuara nga inerte dhe mbetje të ndryshme.

Ky plan hartohet në formë zyrtare, miratohet dhe firmoset nga Kryetarja e Bashkisë dhe zbatohet përgjatë gjithë vitit kalendarik përkatës.